

 <i>Azienda Provinciale per i Servizi Sanitari</i> <i>Provincia Autonoma di Trento</i> Dipartimento strutturale di Medicina di Laboratorio	Formulari i Departamentit Mënyra e mbledhjes së URINËS në 24 orë LINGUA ALBANESE
--	---

Mënyra e mbledhjes së urinës në 24 orë

Për dozimin e disa përbërësve të urinës është e nevojshme të mblidhet e tërë urina që del gjatë 24 orëve në një enë. Për disa analiza, mbledhja duhet bërë me përdorimin edhe të një **konservanti** që **duhet të qëndrojë në enën e posaçme**.

- Ena e përshtatshme për çdo lloj analize duhet tërhequr në laborator ose në pikat e marrjes
- Konservanti mund të shkaktojë acarim në lëkurë, prandaj urina mund të mblidhet fillimisht në një vazo dhe pastaj të derdhet në enën e laboratorit.
- Boshatiseni fshikëzën kur të zgjoheni në mëngjes dhe **mos e mblidhni** këtë urinë.
- Nga ky çast mblidhni në enë të gjithë urinën e bërë gjatë ditës, natës e të parën e mëngjesit të mëpasshëm (ruajeni në vend të freskët, për shembull në banjë, në një vend ku fëmijët nuk mund ta arrijnë).

Në fund të mbledhjes:

- për dorëzimin pranë Qendrave të marrjes që lidhen me Patologjinë klinike të Trentos, Arko, Kavaleze e Kles, masni sasinë e përgjithshme (shkallëzimin në enë) dhe shënojeni në etiketën e epruvetës që është marrë në Laborator. Përzieri urinën dhe mbusheni epruvetën me rreth dy të tretat. Dorëzojeni epruvetën në Qendrën e marrjes.
- për ta dorëzuar në Laboratorët e Patologjisë klinike të Borgos, Roveretos e Tiones, mbylleni me tapë enën dhe dorëzojeni po atë mëngjes në pikat e marrjes gjatë orareve të caktuara.

Disa barna ose ushqime interferojnë në rezultatin e dozimit të disa analizave të posaçme: **Acidi Vanilmandelik (AVM), Acidi 5-Hidroksindolacetik (HIAA), Serotonina, Katekolamine**.

Në këtë rast, për të paktën **tre ditë para fillimit e gjatë mbledhjes** duhet të respektoni udhëzimet e mëposhtme:

- shmangni pirjen e kafesë, çajit, çokolatës dhe ngrënien e bananes, avokados, patlixhanit, ananasit, kumbullës, domates.
- shmangni pirjen e aspirinës, paracetamolit, levodopas, neuroleptikëve, klorofibratit.

MD12 Rev. N° 05 del 23/03/2010	Redatto dal Responsabile ufficio qualità dipartimentale	Approvato dal Direttore di Dipartimento
--------------------------------	---	---